

PROFESOR OSMAN KRAJA

(1930 – 2022)

¹MINA NAQO, ²SPIRO DRUSHKU, ¹ARTUR BAXHAKU, ³FATOS YLLI

¹Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Departamenti i Matematikës

²Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Departamenti i Kimisë Industriale, Seksioni i Inxhinierisë Kimike

³Universiteti i Tiranës, Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar, Departamenti i Metodave Analitike Instrumentale



Profesor Osman Kraja!

Personalitet i jashtëzakonshëm dhe me kontribute të rëndësishme, sidomos në arsimin e lartë shqiptar, ku në vazhdimësi ka punuar dhe drejtuar me pasion, urësi, korrektësi dhe profesionalizëm;

Dekan i Fakultetit të Shkencave të Natyrës (1974 – 1980), Rektor i Universitetit Shtetëror të Tiranës (1981 - 1988), Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Polonisë dhe Ukrainë (1997 - 2002), Nënkyetar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (1992).

Prof. Osman Kraja ka marrë pjesë në hedhjen e bazave të mësimdhënies në shkollën e lartë dhe në modernizimin e fuqizimin e mëtejshëm shkencor të saj në Universitetin e Tiranës. Ai zë një vend nderi në zhvillimin e kombit shqiptar dhe kujtohet gjithmonë me respekt, me mirënjohje dhe me konsiderata të veçanta.

Prof. Osman Kraja është dekoruar në vitin 2002 me urdhrin “Kryqi i artë i Komandantit” nga Presidenti i Republikës së Polonisë, dhe në vitin 2012 është dekoruar me medaljen “Mjeshtër i Madh” nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë.

Prof. Osman Kraja lindi më 1930 në Stamboll, në një familje përparimtare me prejardhje nga krahina e Krajës, Mali i Zi. Para viteve ‘40 familja e tij kthehet në Shqipëri dhe fillimisht u vendosën në Shkodër e më pas në Tiranë.

Në 1949 ai përfundoi me rezultate të shkëlqyera dhe me medalje të artë Gjymnazin e Tiranës, ku mësimdhënës dhe inspirues të tij ishin: Ahmet Gashi, Nonda Bulka, Qazim Turdiu, Abdurrahim Buza, Konstandin Trako etj. Më pas ai vazhdon studimet e larta për matematikë në Universitetin Politeknik të Varshavës, Poloni (1949-1952), ku vlerësohet me medalje të artë për rezultatet e arritura.

Në 1952 ai kthehet në Shqipëri, ku fillon karrierën e mësimdhënies në Institutin e Lartë Pedagogjik (4-vjecar) të Tiranës, i cili ishte institucioni i parë i arsimit të lartë në Shqipëri. Ai u emërua në Katedrën e Matematikës dhe Fizikës të këtij Instituti që drejtohej nga Prof. Petraq Pilika.

Në shtatorin e vitit 1957 inaugurohet Universiteti Shtetëror i Tiranës dhe Prof. Kraja ishte pjesë e këtij universiteti, i konceptuar si një zhvillim i natyrshëm i sistemit arsimor dhe kërkimor të deriatëhershëm (Institutit Pedagogjik, Institutit Politeknik, Institutit Ekonomik, Institutit Juridik dhe Institutit Mjekësor), i mbështetur në njohuritë, entuziazmin e përpjekjet e pedagogëve themelues të tij. Ky institucion u krijua për të plotësuar nevojat në rritje të vendit për specialistë të kualifikuar.

Katedra e Matematikës, që ishte e para katedër e tillë në arsimin tonë të lartë, përbëhej në ato vite nga profesorët e nderuar Petraq Pilika, Qazim Turdiu, Kristaq Fundo, Osman Kraja, Shaban Baxhaku, Aleko Minga, Aristokli Çifliku, Zoja Bozgo, Kristian Bukuroshi, Spiro Makoçi e të tjerë që ju bashkuan më pas.

Në vitin 1958 Osman Kraja u dërgua në aspiranturë në Universitetin "Lomonosov", në Moskë, me qëllim që të krijohej në Katedrën e Matematikës një bërthamë aktive me kualifikim të lartë dhe bashkëkohor. Ai dha me sukses provimet e parashikuara nga programi, ndoqi të gjitha seminarët dhe aktivitetet e tjera, por për fat të keq studimet e aspiranturës u ndërpreën brutalisht me prishjen e marrëdhënieve sovjeto-shqiptare.

Më 1965-1966 Osman Kraja përfundoi kualifikimin e ndërprerë pasuniversitar, duke mbrojtur me sukses disertacionin pranë Institutit të Matematikës së Akademisë së Shkencave të Kinës, nën udhëheqjen e profesorit të njohur Ding Hsiao Shi (Pekin, 1966).

Zgjerimi i mësimdhënies së matematikës në Universitet bëri që në vitin 1964 të krijohet Katedra e Matematikës së Përgjithshme me përgjegjës Prof. Osman Krajën. Më pas, në vitin 1966, bazuar në njohuritë dhe vizionin e zhvillimeve bashkëkohore të shkencës, u krijua profili pesëvjeçar i Degës së Matematikës, me anë të së cilit synohej të përgatiteshin specialistë më të kualifikuar për të siguruar vazhdueshmërinë me nivel të lartë, dhe e cila u realizua edhe me kontributin e veçantë të profesorëve të FSHN, e veçanërisht të Kol Popës, Petraq Pilikës dhe Osman Krajës.

Ndërkohë Katedra e Matematikës së Përgjithshme u zgjerua me specialistë të talentuar dhe u zhvillua në shumicën e drejtimeve të Universitetit të Tiranës. Për atmosferën miqësore të vlerësimit dhe bashkëpunimet në atë Katedër, një

merite e veçantë i takon Prof. Osman Krajës, i cili e drejtoi atë me shumë përgjegjësi për një periudhë prej më shumë se 20 vitesh (1964-1986).

Me kualifikim të lartë shkencor, ai vazhdoi me një aftësi të rrallë dhe metodikë të përsosur të japë leksione të analizës matematike në degët e Matematikës dhe Fizikës, të përgatisë tekste shkollore universitare dhe realizojë kërkimin shkencor dhe njëkohësisht të kontribuojë në drejtimin e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, një fakultet simbol e virtytit dhe solidaritetit njerëzor, i unitetit për të ruajtur dhe mbrojtur vlerat e krijuara, i mos-kompromisit ndaj mosdijes dhe të keqes, i vlerësimit maksimal, deri në fanatizëm, të inteligjencës dhe të punës krijuese, i bashkëpunimit të gjerë pedagog – pedagog dhe pedagog – student. Në vitin 1973 Osman Krajës i jepet titulli “Profesor”, të cilin e mbajti gjatë gjithë jetës me dinjitet dhe me nder.

Në vitin 1968 Universiteti Shtetëror i Tiranës vendosi kontakte me përfaqësuesit më në zë të arsimit të lartë dhe shkencës të Kosovës. Pas Mbledhjes Themeluese të Universitetit të Prishtinës (15 Shkurt 1970), në telegramin e Universitetit të Tiranës shprehej besimi i patundur se “bijtë dhe bijat e vëllezërve kosovarë do t’i përvisheshin me pasion punës për të përvetësuar shkencën dhe diturinë”. Kështu, që nga ai çast nisi një etapë e re në historinë e arsimit kombëtar, dhe pikërisht në korrik 1970, me ftesë të Universitetit të Prishtinës një delegacioni i Universitetit të Tiranës, i kryesuar nga Zv. Rektori, Prof. Osman Kraja, dhe i përbërë nga Prof. Stefanaq Pollo, Prof. Bujar Hoxha dhe Prof. Arben Puto mbërriti plot emocione, mall dhe entuziazëm në Prishtinë.

Për konkretizimin e bashkëpunimit, në tetor të vitit 1970 një delegacion nga Universiteti i Prishtinës i kryesuar nga Rektori Prof. Dr. Dervish Rozhaja, mbërriti në Tiranë ku u nënshkrua Protokollin midis Universitetit Shtetëror të Tiranës dhe Universitetit të Prishtinës nga Prof. Osman Kraja dhe Prof. Dervish Rozhaja. Protokollin filloi të zbatohet menjëherë, që në dhjetor të atij viti dhe të dy palët filluan me nxitim përgatitjet për realizimin e tij. Në atë kohë, angazhimi me gjithë shpirt, kontaktet e shumta me të gjitha institucionet e ngarkuara për zbatimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit nëpërmjet shkëmbimit të pedagogëve dhe kërkuesve të dy universiteteve shqipfolëse, krijimi i kushteve të përshtatshme për qëndrimin në Tiranë të vëllezërve të gjakut dhe të qumështit, janë tashmë pjesë e kontributit të veçantë të Prof. Krajës në historinë e arsimit të lartë të kombit tonë.

Prof. Osman Kraja krahas punës vetëmohuese dhe me pasion të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor ka kryer detyra drejtuese në Fakultetin e Shkencave të Natyrës si Zv. Dekan (1964-1970) dhe Dekan (1974–1980), dhe në Universitetin e Tiranës si Zv. Rektor (1970-1974) dhe Rektor i Universitetit të Tiranës (1981-1988).

Në vazhdimësi, e veçanërisht në postin e lartë të Rektorit të Universitetit, Prof. Kraja ka mbështetur dhe ka inkurajuar kualifikimin pasuniversitar të punonjësve të Universitetit të Tiranës dhe veçanërisht të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, përmes përgatitjes së disertacioneve për Kandidat i Shkencave dhe

Doktor i Shkencave, si në universitetin tonë, ashtu edhe në universitete të mirënjohura europiane.

Prof. Osmani, në vitet e vështira të “qarkullimit në bazë” të pedagogëve të fakultetit/universitetit, që u dërguan të punonin si mësues në shkolla të mesme ose inxhinier prodhimi, ai u kujdes dhe përkrahu çdo njërin prej tyre që të mos shkëpuste lidhjet me fakultetin dhe gjente me zgjuarsi momentin e duhur, duke kapërcyer pengesat e asaj kohe, që ata të ktheheshin përsëri pranë katedrave të tyre.

Në shtator 1992 e nxjerrin në pension.

Në gusht të vitit 1997 Prof. Osman Kraja filloi punë pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme si këshilltar i ministrit dhe më pas me dekret të Presidentit të Republikës emërohet ambasador në Republikën e Polonisë, Ukrainë dhe vendet Baltike (1997-2002). Gjatë ushtrimit të detyrës si ambasador i Shqipërisë, ai ka përfaqësuar denjësisht vendin tonë në takimet e OSBE në Varshavë, dhe veçanërisht ka luajtur një rol tepër aktiv gjatë Luftës çlirimtare të Kosovës (1998-1999), për sensibilizimin e opinionit publik, sistemin e refugjateve në Poloni dhe dërgimin e ndihmave humanitare.

Më pas, për disa vjet ai ka punuar si këshilltar pranë Ministrit të Punëve të Jashtme dhe ka përfaqësuar Shqipërinë në Organizatën e Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi.

Prof. Osmani është pa dyshim një nga figurat më të shquara të arsimit e të kulturës sonë, në mënyrë të veçantë të arsimit universitar. Do të kujtomë përherë fjalët e tij: **"Mendja e një kombi është arsimi"**.

Prof. Osmani, i lidhur që herët me gjuhën, historinë dhe qytetërimin polak, ka ndihmuar që të zhvillohen marrëdhënie të drejtpërdrejta ndërmjet grupeve të interesit, duke inkurajuar grupet e muzikantëve, shkrimtarëve, gazetarëve, kërkuesve, përfaqësuesit e kompanive industriale e tregtare, nga Shqipëria dhe Polonia, të realizonin shkëmbime dhe veprimtari të përbashkëta. Për këtë angazhim shumëvjeçar, ai ishte zgjedhur “Kryetar Nderi” i shoqatës së miqësisë Shqipëri – Poloni.

Prof. Osman Kraja ishte një bashkëpunëtor i mrekullueshëm, një orator i urtë, me një të folur të saktë dhe të baraspeshuar, një njohës dhe përdorues i palëkundur i gjuhës shqipe, me një logjikë perfekte dhe me një trajtim sistematik dhe të kujdesshëm të çështjeve, një njohës i thellë i polonishtes dhe rusishtes dhe përdorues i frëngjishtes, italishtes dhe turqishtes. Ai do të mbetet si gjithmonë një mik i mirë dhe i mençur, i dashur, i kujdesshëm dhe i papërtuar, ndërveprues dhe i qeshur.

Një model i shkëlqyer që frymëzon brezat!

Prof. Osman Kraja u nda nga kjo jetë më 15 qershor 2022.